



UNIVERSITETI I EJL
ЈИЕ УНИВЕРЗИТЕТ
SEE UNIVERSITY

FAKULTETI
I

GJUHËVE, KULTURAVE DHE KOMUNIKIMIT

PROGRAMI STUDIMOR PËR STUDIME PASUNIVERSITARE

(Master of Arts)

TITULLI I PROGRAMIT:

STUDIME PËR GJUHËN ANGLEZE

HYRJE

Fakultetit Peadgogjik	
1. Institucioni/organi për dhënie titullit	Universiteti i EJL-së
2. Institucioni arsimor	Universiteti i EJL-së
3. Vendi i mbajtjes së mësimit	Kampusi i UEJL-së (Tetovë)
4. Program i akredituar nga:	Bordi i akreditimit
5. Grada finale shkencore	M.A.
6. Programi	Magjistraturë e mësimit të gjuhës angleze
7. Data e përpunimit/revizionit	Shtatori 2007
8. Grupi i studentëve	Gjenerata e vitit akademik 2008/2009
9. Qëllimet mësimore të programit	
<ul style="list-style-type: none"> • Qëllimi i programit ELT është t'ju siguroj studentëve njohuri solide nga teoria metodologjike dhe t'i njohë me shkathtësi, të cilat janë të nevojshme për aplikimin e teorisë në mësimin praktik. Zgjedhja e planeve mësimore dhe lëndët individuale janë shprehje e trendëve më të reja për natyrën e miratimit të gjuhës së dytë, si dhe të njohjes së nevojave dhe realiteteve mësimore lokale dhe rajonale. Ndonëse programi është përgatitur për folësit e gjuhës angleze si gjuhë e huaj, ekziston edhe komponentë për studime intensive të gjuhës angleze me theks të veçantë mbi shkrimin dhe leximin akademik. Ekzistojnë edhe komponenta të hulumtimit (kualitative dhe kuantitative), akademike, si dhe “studime moderne” e cila do të zbatohet në klasë. • 	

10. Rezultatet e nxënies së mësimit	
Njohuritë e fituara	Ligjëratat/mësimi, metodat dhe strategjitë e vlerësimit të cilat përdoren për arritjen dhe prezentimin e rezultateve
A. Njohuritë e fituara dhe shqyrtimet e bëra nga:	Ligjëratat /mësimi
<ul style="list-style-type: none"> • 1. Ligjëratat e gjuhës angleze si gjuhë e huaj 2. Njohja e trendëve të fundit në sferën e ELT-së. 3. Përgatitja e programeve mësimore nga sfera e gjuhës angleze për qëllime specifike ESP (English For specific Purposes). 4. Njohja me historinë gjuhësore të ELT-së. 5. Dizajnimi i lëndëve të ELT-së. 	Vlerësimi Evalvimi i vazhdueshëm dhe vlerësimi përfundimtar

6. Praktikimi i të lartshënuarës.	
-----------------------------------	--

B. Shkathtësitë dhe karakteristikat tjera	
<p>Aftësitë për bartjen e shkathtësive intelektuale Pas përfundimit me sukses të programit, studentët mund:</p>	<p>Ligjëratat/mësimi</p>
<ol style="list-style-type: none"> 1. Të mbajnë mësim nga gjuha angleze në sistemin tonë arsimor. 2. Të dizajnojnë lëndë në fushën e ELT-së. 3. Të dizajnojnë lëndë në fushën e Gjuhës angleze për qëllime specifike (ESP). 4. Të vazhdojnë me studime të doktoraturës. 	<p>Programi i ciklit të dytë për mësimin e gjuhës angleze do të përbëhet prej 120 SETK- kredive, ndërsa mësimi do të zhvillohet rregullisht në kohëzgjatje prej katër semestrash (30 kredi për secilin semestër). Programi, në tri semestrat e parë përbëhet prej pesë lëndëve kryesore, ndërsa në semestrin e fundit, të katërtin përgatitja e tezës së magjistraturës.</p>
C. Aplikimi i shkathtësive speciale:	
<p>Pas përfundimit me sukses të programit, studentët mund:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Të mbajnë mësim nga gjuha angleze si gjuhë e huaj sipas standardeve të portofolios angleze. b) Të përgatisin dhe të mbajnë mësim nga gjuha angleze si gjuhë e huaj dhe gjuha angleze për qëllime specifike. c) Të kenë njohuri nga sfera e ELT-së. 	<p>Vlerësimi:</p> <p>Vlerësimi formativ, si dhe vlerësimi përfundimtar përmes mësimin interaktiv të organizuar me përkrahje të jashtëzakonshme dhe udhëheqje nga ana e profesorëve dhe ekspertëve të huaj dhe lokal të sferës së lëndëve specifike në ELT.</p>

Ç. Burimet, hulumtimet, dhe vlerësimi	Ligjëratat/mësimi
<p>Pas përfundimit me sukses të programit, studentët do të mund:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ata të cilët do të diplomojnë në UEJL në fushën e mësimit të Gjuhës angleze, do të marrin diplomë, e cila nuk mund të merret askund në rajon. Kjo është e mundshme, sepse programi është modeluar nga programet më të mira amerikane dhe britanike të magjistraturës dhe është përshtatur për nevojat dhe situata rajonale, me çka pritet që të diplomuarit e ardhshëm jo vetëm të mbajnë mësim, por edhe të ndihmojnë në përgatitjen e gjeneratës së ardhshme të arsimtarëve të gjuhës angleze. Gjithashtu, nëse kihet parasysh se diploma është ndërkombëtare, kjo do t'i rris shanset e të diplomuarve që të punësohen në organizatat ndërkombëtare në vend dhe jashtë vendit, dhe do t'i kualifikojë për praninë të mundshme në programet për doktoratë në fushën e mësimit të Gjuhës angleze. 	<p>Vlerësimi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. teste diagnostike. 2. Dy deri më tre provime me shkrim gjatë semestrit. 3. Një përqindje të caktuar të vlerësimit përfundimtar kanë edhe punimi i seminarit, eseja dhe prezantimi në grupe ose individuale. 4. Testet formative. 5. Testet përfundimtare.

D. Shkathtësitë kryesore: Komunikimi dhe shkrimi	Ligjëratat/mësimi Ligjëratat/mësimi
<p>Pas përfundimit me sukses të programit, studentët do të aftësohen për:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) të mbajtur mësim për shkathtësitë gjuhësore të gjuhës angleze; b) njohjen e trendëve në sferën e ELT_së; c) njohjen e thellë të historisë së ELT-së; ç) për njohje me proceset psikologjike gjatë mësimit të gjuhës angleze si gjuhë e huaj. 	

11. Struktura e programit studimor, kushtet e studimit, niveli, moduli, kreditë dhe mirënjohjet

PRORAMI STUDIMOR I STUDIMEVE PASUNIVERSITARE

Programi i ciklit të dytë për magjistër të gjuhës angleze ka këtë plan mësimor:

<i>Semestri 1</i>	<i>Kreditë</i>	<i>Dim ëror/ Vero r</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët prakti ke</i>	<i>Gjithsej Orët studimo re</i>	<i>Madhësi a e grupeve</i>
Metodika dhe praktika e mësimin të gjuhës së huaj	6	D	22	22	180	25
Gramatika pedagogjike	6	D	22	22	180	25
Metodologjia e hulumtimit shkencor	6	D	22	22	180	25
Aspektet kulturore në ELT	6	D	22	22	180	25
Lënda zgjedhore	6	D	22	22	180	25
Gjithsej	30				900	

<i>Semestri 2</i>	<i>Kreditë</i>	<i>Dim ëror/ Vero r</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët prakti ke</i>	<i>Gjithsej Orët studimo re</i>	<i>Semestri 2</i>
Shkrimi pedagogjik	6	V	22	22	180	25
Ligjërimi i vokabularit	6	V	22	22	180	25
Mësimi dhe përvetësimi i gjuhës angleze	6	V	22	22	180	25
Gjuha angleze për qëllime specifike	6	V	22	22	180	25
Lënda zgjedhore	6	V	22	22	180	25
Gjithsej	30				900	

Lëndët zgjedhore:

1. Të udhëhequrit e klasës;

Ndryshimet dhe plotësimet e programit studimor

2. Dizajnimi i planeve mësimore të ELT-së;
3. Analiza e diskursit.

<i>Semestri 3</i>	<i>Kreditë</i>	<i>Di më ror/ Ver or</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët prakti ke</i>	<i>Gjithsej Orët studimo re</i>	<i>Madhësi a e grupeve</i>
Mësimi i gjuhës me ndihmën kompjuterit	6	D	22	22	180	25
Seminar për shkrimin e tezës së magjistraturës	6	D	22	22	180	25
Fushat e interesit të posaçëm në mësimin e gjuhës angleze	6	D	22	22	180	25
Analiza e nevojave dhe dizajnimi i lëndëve	6	D	22	22	180	25
Lënda zgjedhore	6	D	22	22	180	25
Gjithsej	30				900	

Lëndët zgjedhore 1:

1. Historia e gjuhës angleze
2. Ligjëratat nga konteksti multikulturor
3. Testimi në gjuhën angleze

<i>Semestri 4</i>	<i>Kred itë</i>	<i>Dim ëror/ Vero r</i>	<i>Orët teorike</i>	<i>Orët prakti ke</i>	<i>Gjithsej Orët studimore</i>	<i>Madhësia e grupeve</i>
Punimi i tezës së magjistraturës dhe praktika	30	V	-	-	900	
Gjithsej	30				900	

PËRSHKRIMI I LËNDËVE

M.A. I MËSIMIT TË GJUHËS ANGLEZE (ELT)

1. Metodika dhe praktika e mësimit të gjuhës së huaj (6 kredi)

Përshkrimi i shkurtër i lëndës: Studimi i metodave kryesore të ligjërimit të gjuhës së huaj, duke filluar nga qasja klasike gramatikore, e deri në qasjen komunikuese me një theks të fuqishëm të zbatimit praktik të metodave të mësimit të gjuhës së huaj.

2. Gramatika pedagogjike (6 kredi)

Përshkrimi i shkurtër i lëndës: Qasja praktike në metodat dhe strategjitë më të reja të ligjërimit të gramatikës, duke filluar nga ushtrimet gramatikore, e deri te teknikat e rritjes së vetëdijes.

3. Metodologjia e hulumtimit shkencor (6 kredi)

Përshkrimi i shkurtër i lëndës: Studimi i punës hulumtuese dhe metodave hulumtuese, duke i përfshirë grupimin, të shtruarit e hipotezave, testimin dhe hulumtimin eksperimental. Përmes kësaj lënde, studentët do të fitojnë shkathhtësi të nevojshme për krijimin, zbatimin dhe përfundimin me sukses të projekteve hulumtuese.

4. Shkrimi pedagogjik (6 kredi)

Përshkrimi i shkurtër i lëndës: Qëllimi i studimit të kësaj lënde janë metodat më të reja të ligjërimit dhe shkrimit në mësimin e gjuhës së huaj. Vëmendje e posaçme do t'i kushtohet konceptit të qasjes ndaj prodhimit përkundër qasjes së orientimit ndaj prodhimit.

5. Ligjërimi i vokabularit (6 kredi)

Përshkrimi i shkurtër i lëndës: Kjo lëndë do të përqendrohet në studimin e rrënjëve historike dhe burimeve multidisiplinare prej të cilave rrjedh kjo fushë. Gjithashtu, do të merret edhe me një diapazon të gjerë të strategjive efektive dhe praktike, të cilat do t'ju ndihmojë studentëve në përvetësimin e vokabularit për konverzacion të përdorur më shpesh, studimin akademik dhe fushat profesionale.

6. Përvetësimi dhe studimi i gjuhës së huaj Усвојување и изучување на странски јазик (6 kredi)

Përshkrimi i shkurtër i lëndës: Studimi i aspekteve psikoanalitike të mësimit të gjuhës së dytë dhe të gjuhës së huaj.

7. Gjuhë angleze për qëllime specifike (6 kredi)

Përshkrimi i shkurtër i lëndës: Përmes kësaj lënde studentët do të fitojnë vetëdije kritike dhe kuptimin e parimeve dhe praktikave të gjuhës angleze për qëllime specifike (ESP), si dhe me njohuri dhe shkathtësi pr realizimin dhe zbatimin e efektiv të kurseve të gjuhës angleze për qëllime specifike (ESP) në fusha përkatëse.

8. Të mësuarit e gjuhës me ndihmën e kompjuterit (6 kredi)

Përshkrimi i shkurtër i lëndës: Ky kurs ka për qëllim t'ju sigurojë pjesëmarrësve një pikëpamje më të gjerë dhe të përgjithshme në përvetësimin e gjuhës së huaj me ndihmën e kompjuterit. Ata do të përfshihen në studimin e rrethanave në të cilat zhvillohet mësimi i gjuhës së huaj, përmes shqyrtimit të aplikimeve të mundshme ekzistuese të teknologjisë kompjuteristike në mësimin gjuhës së huaj, si dhe përmes realizimit të projekteve për shfrytëzimin dhe verifikimin e njohurive të fituara gjatë leximit, diskutimeve dhe aktiviteteve konkrete.

9. Fushat me interes të posaçëm në mësimin e gjuhës angleze (6 kredi)

Përshkrimi i shkurtër i lëndës: Kjo lëndë paraqet nuk kurs të vetëm, por më shumë ligjërata dhe seminare për tema aktuale nga fusha e gjuhës angleze. Do të ketë ligjërata nga profesorë ekspertë eminent të kësaj fushe për tema siç janë: mendimi kritik në mësimin e gjuhës angleze; inteligjencie më të madhe, shfrytëzimi i veprave letrare në mësimin e gjuhës angleze, puna me fëmijë të vegjël; mësimi bazuar në detyra konkrete; përmirësimi i gabimeve; dallimet individuale; vlerësimi dhe kështu me radhë.

10. Seminar për shkrimin e tezës së magjistraturës (6 kredi)

Përshkrimi i shkurtër i lëndës: Kurs praktik për shkrimin e tezës së magjistraturës. Midis tjerash, përfshinë edhe studimin në lidhje me atë se si hulumtohet, si selektohet dhe si shfrytëzohet stili, formati përkatës dhe si të shmangen plagjiaturat.

11. Analiza e nevojave dhe dizajnimi i lëndëve (6 kredi)

Përshkrimi i shkurtër i lëndës: Kurs praktik që përbëhet nga masat themelore, nga të cilat kuptohet jo vetëm niveli akademik i studentit, por edhe nevojat specifike për progres akademik. Lënda, gjithashtu këshillon procedura për dizajnimin e lëndës së gjuhës angleze në bazë të nevojave të studentit.

12. Aspektet kulturore në ELT

(6 kredi)

Përshkrimi i shkurtër i lëndës: Kjo lëndë bën analizën e faktorëve kulturor, të cilët ndikojnë në aplikimin e suksesshëm të një pjese të metodologjive të gjuhëve të huaja, por edhe analizën e një pjese të dobësive, të cilat disa metoda dhe qasje i kanë në kontekstin kulturor të një grupi të caktuar.

M.A MËSIMI PËR GJUHË ANGLEZE (ELT)

Teza e magjistraturës (30 kredi): Katedra cakton një semestër prej 900 orësh (sipas SETK), me qëllim të përgatitjes së tezës së magjistraturës. Karakteristikat lidhur me këtë anë përpunuar dhe definuar në pajtueshmëri me universitetet ekzistuese dhe normat qeveritare. Studentët, gjithashtu, marrin edhe instruksione dhe këshilla, si dhe detaje për përgatitjen e rezës së magjistraturës.

Kushtet e regjistrimit

Përveç kërkesave të përgjithshme për regjistrim në programet e ciklit të dytë të UEJL-së, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

- 1) Diploma e studimeve të kryera për Gjuhë angleze, Gjuhë të huaj, Pedagogji, Filologji dhe fusha të ngjashme (180 kredi);
- 2) Njohja e shkëlqyer e gjuhës angleze (580 pikë nga TOEFL, 237 pikë kompjuteristike, 6.5 IELTS);
- 3) Shkathësi themelore kompjuteristike;
- 4) Nota mesatare prej 8.5;
- 5) Mendim pozitiv nga Komisioni i pranimit (kandidatët me diplomë të disiplinave tjera mund t'u nënshtrohen provimeve nga lëndë plotësuese të studimeve deri në diplomim).